



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

Raport
nga monitorimi i faunës së egër në PK Bjeshkët e
Nemuna përmes kamerave kurthë



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" ish pallati i mediave "Rilindja", kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel. 038 211 685, e-mail&ëeb: KEPA@ks-gov.net, www.ammk-rks.net

Rikonfirmohet gjendja e mirë e faunës në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin e zonave të mbrojtura dhe inventarizimin e biodiversitetit, IKMN-ja në bashkëpunim dhe me DAPK “Bjeshkët e Nemuna” nga vizita e fundit në zonën e Grykës së Junikut (Shtator 2017), në kuadër të PK. “Bjeshkët e Nemuna” dhe kontrollimit të kamerave kurth të vendosura kohë më parë në këtë pjesë të parkut kanë konstatuar prezencën e një numri të konsiderueshëm të llojeve të faunës së egër, e ndër to: Lepuri (*Lepus europaeus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), etj. (Foto 1 dhe 10).





Foto 1- 2. Fotot e shtazëve të hasura me kamerën kurth

Kamerat-kurth janë aparate me shkrepje automatike, të pajisura me një sensor i cili detekton lëvizjen e kafshëve me gjak të ngrohtë dhe i fotografon ato në momentin që kalojnë përpara pajisjes. Këto pajisje montohen në drunj apo kunjta të posaçëm. Kjo metodë është jo-intenzive për studimin e faunës, pasi gjeneron informacion në lidhje me praninë dhe numrin e llojeve të ndryshme, pa i shqetësuar ato.

Disa kamera të tilla janë vendosur tash e sa kohë në pjesë të ndryshme të Parqeve Kombëtare “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, me të vetmin qëllim të monitorimit të gjendjes së faunës dhe pranisë së llojeve të ndryshme të shtazëve të egra.

Këto kamera, sikurse deri më sot, pritet të sigurojnë të dhëna të besueshme për gjendjen e faunës në këto zona të mbrojtur.